



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FIER

Nr. \_\_\_\_\_/\_\_\_Prot.

Fier, më .08.2024

**Lënda:** Formulari i njoftimit të fituesit ne perfundim te afateve te ankimimit për proceduren me objekt: **“Blerje pajisje elektronike dhe mobilje për Qendrën Multifunkionale për të Rinjtë, Fier”**, Loti 1: **“Blerje pajisje elektronike për Qendrën Multifunkionale për të Rinjtë, Fier”** REF-11077-06-25-2024 me burim financimi nga Buxheti i Shtetit dhe i Bashkisë Fier

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK  
TIRANË  
(për botim)

Shtojca 11

Bashkia Fier

**Data:** 05.08.2024

**Drejtuar:** Operatorit ekonomik INSTANT.AL SHPK

**Adresa:** Tirane Rr. Ali Demi perballe "Fushes se Zeze", Tirane, Tirane zona kadastrale 8150 ,numri i pasurise 8/801- B1

NUIS L81506043D

**\* \* \***

Procedura e prokurimit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar me mjete elektronike**

**Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-11073-06-25-2024**

**Loti 1: “Blerje pajisje elektronike për Qendrën Multifunkionale për të Rinjtë, Fier” REF-11077-06-25-2024**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Loti 1: “Blerje pajisje elektronike për Qendrën Multifunkionale për të Rinjtë, Fier”**, me fond limit/vlera e pritshme e kontratave prej **Loti 1: Blerje paisje elektronike për Qendrën Multifunkionale për të Rinjtë, Fier – 3 119 914.30 (tre milion e njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e katërmëdhjetë pike tridhjetë) lekë pa TVSH**

me burim financimi nga Buxheti i Shtetit dhe i Bashkise Fier, në perputhje me preventivat, sasitë, specifikimet teknike dhe kushtet e përcaktuara në DST.

Afati kohor për ekzekutimin e kontratës: - **Jo më vonë se 20 ditë nga nënshkrimi i kontratës per LOTIN nr.1**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [29 Korrik 2024], [Numri 42].

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **PO**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1.Operatori ekonomik INFOSOFT SYSTEM SHPK me NUIS J61820021C. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 2 535 000 (dy milion e pesëqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

2.Operatori ekonomik BNT ELECTRONICS me NUIS J61817047D. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 2 886 840 [dy milion e teteqind e tetedhjetë e gjashtë mije e teteqind e dyzete) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

3. Operatori ekonomik XPERT SYSTEMS SHPK ME NIPT L51511023L. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 2 265 000 (dy milion e dyqind e gjashtedhjetë e pese mije ) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

4.Operatori ekonomik QuantX IT Solutions SHPK, me NUIS M31904013D. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 2 339 936 [dy milion e treqind e tridhjetë e nente mije e nenteqind e tridhjetë e gjashtë ) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

5. Operatori ekonomik INSTANT.AL SHPK, me NUIS L81506043D. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 2 340 000 [Dy milion e treqind e dyzete mije ] lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

6. Operatori ekonomik OpenTech consulting & Services SHPK, me NUIS L41329019U. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 2 539 000 [Dy milion e peseqind e tridhjetë e nente mije ] lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

**\*\*\*\***

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- 1 Operatori ekonomik XPERT SYSTEMS SHPK ME NIPT L51511023L
2. Operatori ekonomik QuantX IT Solutions SHPK me NUIS M31904013D
3. Operatori ekonomik OpenTech consulting & Services SHPK, me NUIS L41329019U

Perkatesisht per arsyet e meposhtme:

1. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dhe verifikoi dokumentacionin ligjor, ekonomik dhe teknik, të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik pjesëmarrës XPERT SYSTEMS SHPK me NUIS L51511023L, konstatoi mangësit si më poshtë:

Referuar Shtojcës 7, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.3, përcaktohet se:

- 2.3.3 ” Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë/broshurë, per zerat e mallrave sipas tabelës se mëposhtme, nga prodhuesi (*sipas autorizimit të prodhuesit ose distributorit të autorizuar*) ku të jete të percaktuar zerat e mallrave dhe specifikimet teknike të tyre (*të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar*). Në katalogë/broshura duhet të markohen (*per lehtësi identifikimi*) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara ne DST.

**Tabela me zerat e mallrave per te cilat duhet te paraqiten katalogë/broshurë :**

Nr.	Emertimi i mallrave
1.	Kompjuter Desktop
2.	Laptop
3.	FV TV Led Smart (4K,65’')
5.	FV TV Led (8K,85’')

”

Në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur kataloge për Laptop, FV TV Led Smart (4K,65’'), FV TV Led (8K,85’'), ndërsa për Kompjuter Desktop ka paraqitur katalog vetëm për njësinë qendrore modeli Thing Centre Neo 50t Gen 4 dhe nuk ka paraqitur katalog për monitorin, siç është kërkuar në specifikimet teknike të hedhura në SPE nga AK (Shtojca 5).

\*\*\*\*\*

2. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dhe verifikoi dokumentacionin ligjor, ekonomik dhe teknik, të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik pjesëmarrës QuantX IT Solution SHPK me NUIS M31904013D, konstatoi mangësit si më poshtë:

Referuar Shtojcës 7, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.2, përcaktohet se:

- 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim distributori per zerat e mallrave sipas tabelës se mëposhtme. Ne rast se do të paraqitet autorizim distributori duhet të provohet dhe lidhja midis prodhuesit dhe distributorit. Secili nga dokumentat duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK ne rast verifikimi nga ana e tij. Autorizimi duhet të jete i vlefshem ne momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave si dhe origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara.

**Tabela me zerat e mallrave per te cilat duhet te paraqiten autorizim prodhuesi ose autorizim distributori:**

Nr.	Emertimi i mallrave
1.	Kompjuter Desktop
2.	Laptop
3.	FV TV Led Smart (4K,65’')
5.	FV TV Led (8K,85’')

Në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur autorizim distributori vetëm për Kompjuter Desktop dhe Laptop. OE nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi apo distributori për FV TV Led Smart (4K,65’’) dhe FV TV Led (8K,85’’).

\*\*\*\*\*

3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dhe verifikoi dokumentacionin ligjor, ekonomik dhe teknik, të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik pjesëmarrës OpenTech consulting & Services SHPK me NUIS L41329019U, konstatoi mangësit si më poshtë:

Referuar Shtojcës 7, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.2, përcaktohet se:

- 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim distributori për zerat e mallrave sipas tabelës së mëposhtme. Në rast se do të paraqitet autorizim distributori duhet të provohet dhe lidhja midis prodhuesit dhe distributorit. Secili nga dokumentat duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave si dhe origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara.

**Tabela me zerat e mallrave për të cilat duhet të paraqiten autorizim prodhuesi ose autorizim distributori:**

Nr.	Emertimi i mallrave
1.	Kompjuter Desktop
2.	Laptop
3.	FV TV Led Smart (4K,65’')
5.	FV TV Led (8K,85’')

Në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur autorizim distributori vetëm për FV TV Led Smart (4K,65’’) dhe FV TV Led (8K,85’’), ndërsa për Kompjuter Desktop dhe Laptop, OE nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi apo distributor.

- Referuar Shtojcës 8, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, Seksioni B: DEKLARATA në pikën 6, kërkohet të plotësohet:

*“Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):*

a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;

b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit)

”

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të ngarkuar në SPE nga OE OpenTech consulting & Services SHPK, konstatoi se kjo pikë nuk është plotësuar nga OE”.

\*\*\*\*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik INSTANT.AL SHPK, me NUIS L81506043D me adrese: Tirane Rr. Ali Demi perballe "Fushes se Zeze", Tirane, Tirane zona kadastrale 8150,numri i pasurise 8/801- B1, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej 2 340 000 [dy milion e treqind e dyzete mije ] lekë pa TVSH dhe prej 2 808 000 [Dy milion e teteqind e tete mije] lekë me TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë autoritetit kontraktor Bashkia Fier Lagja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Fier , sigurimin e kontratës brenda **20 (njëzetë)** ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO  JO x  
Nëse Po

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO  JO   
Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Armando SUBASHI**